

Udhëzues për Krijimin e Rrjetit të Vëzhguesve për Zonat e Mbrojtura në masivin malor Sharr-Korab.



Bukurosh Onuzi

Ekspert i Zhvillimit komunitar

Contents

.....	0
Rreth projektit	2
Rreth zonës Sharr-Korab	2
Rrjeti i Vëzhguesve të Zonave të Mbrojtura	3
Roli dhe Përgjegjësitë	3
Parku ka nevojë për komunitete të forta kundërshtuese:	3
Strukturat e Menaxhimit të ZM.	4
Struktura komunitare ose vendore	4
Veprimtaritë ekonomike në zonat e Mbrojtura	5

KRIJIMI I RRJETIT TË VËZHguesve KOMUNITARË TË ZONAVE TË MBROJTURA

Rreth projektit

Projekti “Mbrotja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura ndër-kufitare në Malin e Sharrit, Mavrovës dhe Korab-Koritnik”, fokusohet në qeverisjen e mirë të zonave të mbrojtura në kufirin ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke mbuluar më shumë se 186,000 hektarë të Zonave të Mbrojtura (ZM) të Malit Sharr, Mavrovës dhe Korab-Koritnik.

Ky projekt zbatohet nga Fondacioni ALCDF, në partneritet me organizata partnere lokale në Maqedoninë e Veriut, CSDC (Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit) dhe GLV "Dibra Turistike" në Shqipëri.

Projekti financohet nga PONT – Fondi i Besimit për rajonin e Prespës dhe Ohrit, program gjerman, i cili i kushtohet ruajtjes së trashëgimisë së pasur të zonave natyrore në zonat e mbrojtura dhe korridoreve ekologjike lidhëse të Greqisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Rreth zonës Sharr-Korab

- Sharr-Korab është një nga zonat më të mëdha të mbrojtur në Europë, në masivin malor Sharr-Korab me 244,000 ha, bashkë me Parqet Kombëtare të Sharrit në Kosovë, Mavrovë dhe Mali i Sharrit në Maqedoninë e Veriut, dhe Parkut Natyror Korab-Koritnik në Shqipëri;
- Projekti "Mbrotja dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Zonave të Mbrojtura në Malin Sharr, Mavrovë dhe Korab-Koritnik", i zbatuar nga ALCDF, është i fokusuar në zonat e mbrojtura ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, duke mbuluar më shumë se 191,338 hektarë të ZM, konkretisht. në: Parku Nacional Mali i Sharës (62.700 ha); Parku Kombëtar i Mavrovës në NMK (73,088 ha); dhe parku natyror Korab-Koritnik në AL (55,550 ha).
- Autoritetet e Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur (PAMA) janë në katër zyra, konkretisht në Mavrovë për PK të Mavrovës, Tetovë për PK të Malit Sharr, Dibër dhe Kukës për PK të Korab-Koritnik.
- Zonat e mbrojtura kanë një popullsi të drejtpërdrejtë prej rreth 44,600 banorë, duke përfshirë 10 njësi të qeverisjes vendore (bashkitë dhe komunat), konkretisht Bashkitë Dibër dhe Kukës, me një popullsi prej rreth 19,000 banorë (në Parkun Natyror Korab-Koritnik), Bashkitë e Mavrovës-Rostushë dhe Gostivar (Parku Kombëtar i Mavrovës), me një popullsi të përgjithshme prej rreth 8,600 banorë, dhe në Sharr Parku Nacional Malor me një popullsi prej rreth 17,000 banorë në shtatë komuna (Bogovinë, Gostivar, Jegunovcë, Mavrovë-Rostushë, Tearcë, Tetovë dhe Vrapçisht).

Rrjeti i Vëzhguesve të Zonave të Mbrojtura

Roli dhe Përgjegjësitë

- Funkcion/detyrë e deleguar nga ADZM, tek kryetari i fshatit dhe komisioni në fshat (raingers komunitare).
- Ngritjen e një grupi bazë me të paktën 3 persona për çdo fshat.
- Detyrat kryesore të një grupi ose komisioni të vëzhguesve të ZM janë:
 1. Vrojtimin e ndërhyrjeve ilegale, si:
 - prerja e druve;
 - gjuetia e paligjshme apo përdorimi i armëve;
 - kullotja e bagëtive në zonat e ndaluara;
 - mbledhja e parregullt e bimëve mjekësore;
 - ecja me makina 4x4 dhe motorë në livadhe dhe kullota, etj.
 - kultivimi i bimëve dhe specieve të ndaluara.
 2. Sinjalizimin e zjarreve dhe marrjen e masave parandaluese/izoluese.
 3. Vëzhgimin në teren të përdoruesve të veprimtarive ekonomike nëse shkelen apo zbatohen kushtet e shfrytëzimit dhe përdorimit.
 4. Monitorimi ditor i shfrytëzimit të burimeve natyrore që janë dhënë me konçesion ose leje mjedisore, që të jenë sipas standarteve teknike dhe ligjore.
 5. Kontrollin e territorit nga shkelës të paligjshëm.
 6. Sinjalizon organet e tjera për marrjen e masave për rehabilitimin e dëmtuesve natyrorë të florës dhe faunës, si dhe të burimeve të tjera natyrore.
 7. Jep informacionin e parë teknik për spotet e degraduara, të shfrytëzuara, prioritet e ndërhyrjes, zonat dhe vlerësim opinionit paraprak për shfrytëzimin e burimeve natyrore.
- Ka varësi kordinuese dhe menaxheriale nga kryetari i fshatit dhe Njësia Administrative.
- Pajiset me mjet identifikimi, pajisjet e duhura informuese dhe teknike për parandalimin e zjarrit, kundër dëmtuesve natyrorë, etj.
- Ka kontakt në rrjetin e njësisë së emergjencave civile.

Parku ka nevojë për komunitete të forta kundërshtuese:

- Në mbrojtje të parkut nga zjarri, shkelësit e ligjit, dëmtuesit, dhe abuzuesit e tjerë me pasuritë natyrore.
- Kundër shfrytëzimit jo siç duhet të pasurive dhe territorit të parkut nga të tjerët, qofshin këto biznese, vizitorë, kalimtarë apo palë të tjera të interesuara.
- Të denocojnë shkelësit, dëmtuesit, dhe abuzuesit e pasurive të parkut në organet ligjzbatuese.
- Kundër ndërhyrjeve të parregullta ilegale, si:

1. prerja e druve;
 2. gjuetia e paligjshme apo përdorimi i armëve;
 3. kullotja e bagëtive në zonat e ndaluara;
 4. mbledhja e parregullt e bimëve mjekësore;
 5. ecja me makina 4x4 dhe motorë në livadhe dhe kullota, etj.
- Të protestojnë dhe ngrejnë zërin për shfrytëzimin e parregullt nga kompanitë konçesionare dhe ndërtuese në:
 1. gurore, apo shfrytëzimin e zhavorit në shtratin e lumenjve;
 2. hapjen e rrugëve malore pa cilësi dhe kriter;
 3. marrjen e ujit pa kriter për HEC ose qëllime të tjera;
 4. çështje të tjera që bien ndesh me standartet mjedisore dhe rregullat e zonave të mbrojtura.
 - Të kërkojnë llogari nga ADZM për përmbushjen e detyrimeve të tyre.

Për më shumë dijeni:

Strukturat e Menaxhimit të ZM.

- Ministria e Planifikimit Hapsinor është organi më i lartë shtetëror përgjegjës për politikën, ligjet, rregullat, planet e menaxhimit, buxhetin, titujt e pronësisë, etj, për zonat e mbrojtura.
- Parku Nacional është organi më i lartë përgjegjës për Administrimin dhe Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura në territor. Përcakton veprimtaritë në zonën e mbrojtur, lejet e përdorimit dhe ushtrimit të aktiviteteve ekonomike apo studimore, vendos tarifat dhe buxhetet, emëron stafin dhe drejtuesit.
- “Këshilli i palëve të interesit”, është strukturë e përbashkët, monitorojnë veprimtarinë e Parkut në rajon, zbatimin e planeve të menaxhimit, zbatimin e legjislacionit nga administratat e parkut, zbatimin e kërkesave për përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Struktura komunitare ose vendore

- Pushteti lokal (fuqinë si autoriteti i pushtetit vendor, pronat, planet e menaxhimit, strukturat, specialistët, buxhetin, mjetet, etj.)

- Këshillat e fshatrave, fuqi qeverisëse në nivel fshati të deleguar me ligj nga pushteti lokal. Ka shërbime publike, menaxhon prona, menaxhon burime natyrore, zgjidhje konfliktesh, ngre komisione dhe grupe komunitare me veprimtari sociale, kulturore dhe ekonomike, ushtron autoritetin qeverisës, përfaqëson fshatin, ka përgjegjësi informuese, kontrolluese/monitoruese, etj.
- Strukturat me bazë komunitare, këshillimore dhe me veprimtari social ekonomike, dhe kulturore.

Veprimtaritë ekonomike në zonat e Mbrojtura

- Në zonat e mbrojtura mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, shoqërore, turistike, kërkimore-shkencore etj, sipas kërkesave të ligjit.
- Në zonat e mbrojtura, veprimtaritë mund të ushtrohen vetëm pasi të jetë marrë më parë leja e mjedisit ose pasi të jetë marrë miratimi i organit të mbrojtjes së zonës, në rastet kur kjo kërkohet shprehimisht nga ky ligj. Disa nga veprimtaritë e lejuara janë:
 1. Material drusor për ngrohje apo ndërtim sipas tarifave përkatëse për komunitetin dhe për subjektet private.
 2. Kullotja me leje dhe ngritja e staneve (për të imta, gjedhët, njëthundrak, bletë, etj.)
 3. Grumbullim dhe përdorim i prodhimeve të dyta të pyllit (mbeturina pylli, lëvore, boçe, gjethe, fruta, humus, etj.)
 4. Kultivimi i bimëve të ndryshme mjekësore, aromatike, dhe eterovajore.
 5. Mbarështrim të faunës së egër.
 6. Objekte për veprimtari turistike, tregtie, bare, restorante, hotele, kampingje, etj.
 7. Vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, të radiokomunikimit.
 8. Kryerjen e operacioneve shpim-kërkim uji, minerare, gazi, naftë, shtrirje tubacionesh në sipërfaqe, ndërtim linje tensioni të lartë, ndërtim kanalesh,
 9. Xhirime dhe filmime për efekte televizive dhe personale.
 10. Ecje në natyrë, vrojtime, apo lëvizje me mjete motorike të lejuara si biçikleta, kuaj, apo hedhje me parashutë, etj.
 11. Për peshkim dhe përdorim mjetetesh lundruese.
 12. Për veprimtari shkencore dhe hulumtuese, për të marrë kampione apo përdorur të dhënat ekzistuese.